

REPUBLICA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE SHKALLA E PARË

VLORË

Nr.1618 Akti  
Datë 08.09.2014

Nr.1480 Vendimi  
Datë 08.10.2014

**V E N D I M**

**"NË EMËR TË REPUBLIKËS"**

Gjykata Administrative e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e përbërë nga:

**GJYQTARE: Gentiana XHELILI (RROKAJ)**

asistuar prej sekretares gjyqësore Milena Mersini, sot më datë 08.10.2014 mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore publike, çështjen civile nr.1618 Akti, që u përket palëve:

**PADITËSE:** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, përfaqësuar në gjykim nga juristët Armela Divija dhe Majlinda Ferron me autorizimin me nr.3013 prot, datë 23.09.2014.

**I PADITUR:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier (në mungesë);  
Drejtoria e Apelimit Tamitor Tiranë, me adresë Rruga 'Gjin Bue Shpata' pranë Stadiumit Dinamo (në mungesë).

**PERSON I TRETË:** Ministria e Financave, Zyra e Thesarit Fier, përfaqësuar në gjykim nga Drejtoresha Trëndelina Sulçe,

**OBJEKTI:** Shfuqizimin e aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.68888 prot, datë 05.05.2014 për detyrimet gjobë e kamatëvonesave për pagesë të vonuar për kontribute të sigurimeve shoqërore shëndetësore për periudhën 2014/02 të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier dhe vendimit të Drejtorisë së Apelimit Tatimor nr.11387/1 prot, datë 04.08.2014. Rregullimin e pasojave, pasqyrimin në sistem në këtë mënyrë, gjendja kreditore prej 272866 lekë e sigurimeve shoqërore 2013/12 të kalojë të pasqyrohet për sigurime shoqërore 2014/02.

**Baza ligjore:** Neni 3,4,118,119 të K.Pr.Administrative, nenet 2,4,7 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, pasi administroi provat shkresore, dëgjoi pretendimet e përfaqësueses së palës paditëse, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, Majlinda Ferro e cila kërkoi pranimin e kërkesë-padisë, përfaqësuesja e personit të tretë dega e Thesarit Fier, Trëndelina Sulçe e cila kërkoi pranimin e kërkesë padisë sipas objektit të saj, palët e paditura në mungesë nuk u dëgjuan dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi,



## V Ë R E N

Se pala paditëse Gjkata e Rrethit Gjyqësor Fier i është drejtuar Gjykatës Administrative Vlorë me kërkesë-padinë me objektin e mësipërm.

Përpara shqyrtimit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë në prova të kërkesëpadisë, gjykata konstatoi se në bazë të neneve 7,10,11 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", çështja objekt gjykimi hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore dhe tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Ne baze të nenit 12 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", gjykimi u zhvillua me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar.

### **Rrethanat e faktit**

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se pala paditëse Gjkata e Rrethit Gjyqësor Fier është njoftuar për "Njoftim Vlerësimi për detyrimet Tatimore nr.4155 prot, dt.19.03.2014, për detyrimet, gjobë për pagesë të vonuar për kontribute të sigurimeve shoqërore shëndetësore për periudhën 2013/12 të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, rezulton se Gjkata e Rrethit Gjyqësor Fier për periudhën tatimore 2013/12 ka detyrim për dorëzim të vonuar - gjobë 40929 lekë e kamatëvonesë 4496 lekë. Me Aktin Administrativ - Njoftim Vlerësimi për detyrimet Tatimore nr.6888 prot., dt.05.05.2014, për detyrimet, gjobë për pagesë të vonuar për kontribute të sigurimeve shoqërore shëndetësore për periudhën 2014/02 të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore FIER, rezulton se Gjkata e Rrethit Gjyqësor Fier për periudhën tatimore 2014/02 ka detyrim për dorëzim të vonuar - gjobë 13643 lekë e kamatëvonesë 463 lekë dhe për periudhën tatimore 2013/12 ka detyrim për dorëzim lekë - gjobë 40929 lekë e kamatëvonesë 4496 lekë.

Me vendim të Drejtorisë së Apelit Tatimor nr. 7513/3 prot. nr. 7513/3 prot, 24.06.2014 është vendosur - Shfuqizimi i Aktit Administrativ - njoftim Vlerësimi për detyrimet Tatimore nr.4155 prot., dt. 19.03.2014, për detyrimet tatimore, gjobë e kamatëvonesë për pagesë të vonuar për kontribute të sigurimeve shoqërore shëndetësore për periudhën 2013/12 të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore FIER.

Me vendim të Drejtorisë së Apelit Tatimor nr. 11387/1 prot, dt.04.08.2014 është vendosur: Lënia në fuqi e Aktit Administrativ - Njoftim Vlerësimi për detyrimet Tatimore nr.6888 prot., dt.05.05.2014, për detyrimet, gjobe për pagesë të vonuar për kontribute të sigurimeve shoqërore shëndetësore për periudhën 2014/02 të nxjerre nga Drejtoria Rajonale Tatimore FIER.

Bazuar në Vendimin e Drejtorisë së Apelit Tatimor nr. 11387/1 date 04.08.2014 mbërritur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier me date 08.08.2014, brenda afatit ligjor, pala paditëse ka paraqitur padinë me objekt kundërshtimit të aktit administrativ.

Rezultoni se me date 18.03.2014, Gjkata e Rrethit Gjyqësor Fier është njoftuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për detyrime të papaguara në



AP/dhe per gjendje kreditore ne Sigurimet Shoqerore ne shumen 272.866 leke.

Me shkresën nr. 14138 prot, datë 199.03.2014 Drejtoria Rajonale Tatimore Fier është drejtuar gjykatës për origjinën e këtij detyrimi dhe është konstatuar se ky detyrim vjen nga periudha Dhjetor 2013. Shuma prej 272.866 lekë është detyrimi i Gjykatës për tatime TAP për periudhën Dhjetor 2013. Nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është dorëzuar në Degën e Thesarit Fier, Urdhër-Shpenzimi nr. 4 datë 06.01.2014 dhe është aprovuar me datë 09.01.2014, brenda afatit të pagesës së detyrimeve për tatime e sigurime shoqerore që është data 20 e muajit pasardhës. Me dorezimin e Urdhër-Shpenzimit në Degën e Thesarit dhe marrjen e konfirmimit, nga ana e gjykatës Fier konsiderohet i kryer veprimi finaciari. Nga specialistja e Degës së Thesarit Fier janë bërë veprimet për hedhjen në sistem të pagesave të tatimeve dhe sigurimeve shoqerore dhe shuma e mesiperme është hedhur *qabimisht* në llogarinë e sigurimeve shoqerore. Pra Gjykata pasqyrohet Kreditore në Sig. Shoqerore me 272.866 leke dhe debitorë në Tap në masën 272.866 leke.

Këtë veprim për pagesën e tatimit TAP e ka sistemuar punonjësja e Degës së Thesarit me pagesat e detyrimeve për periudhën Shkurt 2014.

Pas mbërritjes në institucion të Njoftimit të Vlerësimit për Detyrimet Tatimore, pala paditëse ka dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve shkresën nr. 962 datë 24.03.2014 "Kerkese për apelim" ku kërkojmë sistemin e detyrimeve që rrjedhin për shkak të një gabimi nga punonjësja e Degës së Thesarit.

Me datë 04.04.2014 është dërguar shkresa e Drejtorisë së Apelit Tatimor nr. 7513/1 "Kerkese për plotësim dokumentacioni", se ciles iu kthye përgjigje me shkresën nr 1265 datë 14.04.2014.

Me datë 09.04.2014 është nxjerre nga sistemi i tatimeve Urdhër Pagesa TAP për periudhën tatimore Dhjetor 2013 me shumën si më poshtë: Gjoke për pagesë të vonuar

54572

Interes i vendosur 9.10% e detyrimit

2380

Interes i vendosur 8.84 % e detyrimit

2579

Nga operatorja e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier është firmosur urdher pagesa dhe është komunikuar shuma që duhet të paguhet 4959 leke, pra vetëm interesat, shume e cila është paguar nga ana e gjykatës Fier me Urdhër- Shpenzimin nr.72 datë 10.04.2014.

Gjithashtu është nxjerre edhe Urdhër Pagesa Sigurimeve Shoqërore për periudhën tatimore Shkurt 2012 me shumën si më poshtë:

Gjoke për pagesë të vonuar 27.286

Interes i vendosur 992

Nga operatorja e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier është firmosur urdher pagesa dhe është komunikuar shuma që duhet të paguhet 992 leke, pra vetëm interesat, shume e cila është paguar nga gjykata Fier me Urdhër-Shpenzimin nr.71 datë 10.04.2014.

Me datë 07.05.2014 nga pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier është njoftuar pala paditëse me shkresën nr. 6888 prot, Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore.



Pas marrjes se ketij njoftimi, nga ana e gjykates Fier eshte derguar Kerkese per Apelim per Drejtorine e Apelimit Tatimor ku kerkohet sistemimi i gjobave te pershkruara me siper.

Me date 20.06.2014 eshte kerkuar nga Drejtoria e Apelimit Tatimor nje proces-verbal ku te evidentohet veprimi i kryer nga punonjesja e Deges se Thesarit Fier, per hedhjen ne sistem te detyrimeve te tatimeve per periudhen Dhjetor 2013, proces-verbal i cili eshte derguar me shkresen nr. 1272 date 20.06/2014 te Deges se Thesarit Fier, dhe me shkresen nr. 2228 date 25.06.2014 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Fier.

Më datë 26.06.2014 del Vendimi i Drejtorise se Apelimit Tatimor i cili shfuqizon aktin administrativ Njoftim Vleresimi Tatimor nr. 4155 date 19.03.2014 te leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier ku citohet se : *"Tatimpaguesi Gjykata e Rrethit Gjyqesor Fier ka permbushur detyrimin ligjor per deklarim dhe pagese per llofin e tatimit TAP me deklarim, per priudhen Dhjetor 2013, ne shumen 272.866 leke, pagesa te cilat kane kaluar ne daten 14.01.2014, si dhe nuk eshte perqejjesi e tij percaktimi i qabuar i Llogarise, por i Deges se Thesarit. DAT do te anulloje detyrimin per gjoba per pagese te vonuar ne shumen 40.929 leke, pasi pagesa e detyrimit me deklarim TAP ne shumen 272.866 leke, periudha Dhjetor 2013, konsiderohet e kryer brenda afatit te percaktuar ne ligjin specifik. I njejti arsyetim vlen dhe per detyrimin per kamatevonesa, kjo, duke gjykuar se nuk kemi te bejme me detyrim tatimor te papaguar ne afat, per rrjedhoje nuk mund te llogariten detyrime per kamatevonesa".*

Me date 08.08.2014 del vendimi i Drejtorise se Apelimit Tatimor i cili le ne fuqi aktin administrativ Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore me nr. 6888 date 05.05.2014, per detyrimet, gjobe per pagese te vonuar per kontribute te sigurimeve shoqerore e shendetesore per periudhen 2014/02 nxjerre nga D.R.T. Fier, detyrime keto qe jane rrjedhoje e veprimit te kryer per TAP ne periudhen Dhjetor 2013.

Nga veprimet e mësipërme, rezulton se Gjykata e Rrethit gjyqësor Fier pasqyrohet Kreditore ne Sig.Shoqerore me 272.866 leke dhe debitore ne Tap ne masen 272.866 leke, Kete veprim per pagesen e tatimit TAP e ka sistemuar punonjesja e Deges se Thesarit me pagesat e detyrimeve per periudhen Shkurt 2014.

Nga Gjykata Fier eshte dorezuar Urdher Shpenzimi nr.38 st. 11.03.2014 ne Degen e Thesarit, pra perpara dt.20 te ketij muaji qe eshte afati i fundit sipas ligjit, dhe nga dega e thesarit per ne Drejtorine Rajonale Tatimore Fier, jane kryer veprimet ne dt. 17.03.2014.

Pala paditëse Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier kërkon shfuqizimin e aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.6888 prot, datë 05.05.2014 për detyrimet gjobat dhe kamatonesat për pagesë të vonuar për kontribute të sigurimeve shoqërore për periudhën 2014/02 nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimeve Fier dhe vendimit nr.11387/1 prot, datë 04.08.2014 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor duke parashtruar se;



**Së pari;** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier nuk ka kryer asnjë pagesë në vonesë ashtu siç është pretenduar nga pala e paditur, pasi është paraqitur në Zyrën e Thesarit dhe është bërë gabim nga Zyra e Thesarit Fer.

**Së dyti;** vendimi nr. 6888 datë 05.05.2014 i Drejtorise Rajonale Tatimore Fier, është akt administrativ relativisht. i pavlefshëm, në kuptim të K.Pr.Administrative e si i tillë duhet të shfuqizohet e të rregullohen pasojat e krijuara prej tij meqenese tashme pas shfuqizimit nuk mund të prodhojë me efekte ligjore dhe pasqyrimi në sistemin e Drejtorise Rajonale Tatimore Fier duhet të saktësohet.

**Së treti;** Po kështu duhet të shfuqizohet edhe vendimi i Drejtorise së Apelit Tatimor nr. 11387/1 prot, dt.04.08.2014, i cili ka vendosur - Lenia në fuqi e Aktit Administrativ - Njoftim Vleresimi për detyrimet Tatimore nr.6888 prot., dt.05.05.2014, për detyrimet, gjobe për pagese të vonuar për kontribute të sigurimeve shoqërore shëndetësore për periudhën 2014/02 të nxjerre nga Drejtoria Rajonale Tatimore FIER.

Sa më sipër, pala paditëse Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier kërkon;  
*Shfuqizimin e Aktit Administrativ - Njoftim Vleresimi për detyrimet Tatimore nr.6888 prot., dt.05.05.2014, për detyrimet, gjobe e kamatevonesë për pagese të vonuar për kontribute të sigurimeve shoqërore shëndetësore për periudhën 2014/02 të nxjerre nga Drejtoria Rajonale Tatimore FIER dhe vendimit të Drejtorise së Apelit Tatimor nr. 11387/1 prot, dt.04.08.2014 dhe rregullimin e pasojave, pasqyrimin në sistem në këtë mënyrë: gjendja kreditore prej 272.866 leke e Sigurimeve Shoqërore 2013/12 të kalojë e të pasqyrohet për Sigurime Shoqërore 2014/02.*

***Përfaqësuesja e personit të tretë Dega e Thesarit Fier ka kërkuar pranimin e kërkesë padisë duke parashtruar se;***

Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier është kryer pagesa për tatim mbi pagën por gabimisht nga punonjësja e Thesarit Fier është zgjedhur llogaria me nr.4361120 që është llogari e sigurimeve shëndetësore dhe në muajin mars 2014 i është komunikuar Gjykatës se do të bëhet sistemimi.

Nga Dega e Thesarit nuk i është shkaktuar dëm ekonomik shtetit pasi janë derdhur të ardhurat në buxhetin e shtetit, por janë derdhur nga një llogari në tjetrën në po të njëjtin institucion dhe për këtë arsye duhet të shfuqizohet gjoba e vendosur ndaj palës paditëse Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.

**Gjykata pasi ka administruar provat dhe ka analizuar në tërësi çështjen, çmon se kërkesë-padia është e bazuar në ligj dhe në prova dhe duhet të pranohet.**

**Arsyetimi ligjor**

Në nenin 15 të ligjit nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se "

*Të drejtën e padisë e ka:*

*a)organi i administratës publike, që pretendon se është cënuar në ushtrimin e kompetencave nga një akt administrativ apo nga një akt nënligjor*



formativ i paligjshëm, i një organi publik, me të cilin nuk ka idhje varësie hierarkike. Në këtë rast organi mund të kërkojë zgjidhjen e mosmarrëveshje së kompetencës dhe/ose shfuqizimin e aktit.

Rezulton se pala paditëse Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka një interes legjitim për të kërkuar anulimin e njoftimit vlerësim-tatimor me nr.6888 prot, datë 05.05.2014 për arsye se pala e paditur në nxjerrjen e këtij akti administrativ nuk ka zbatuar ne mënyrë të drejtë ligjin "Për procedurat tatimore".

Çështja objekt gjykimi rregullohet nga ligji nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore " i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij dhe udhëzimi nr.24, datë 02.09.25008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Në nenin 10 të ligjit 'Për tatimin mbi të ardhurat personale' parashikohet se: *Çdo punëdhënës, që paguan një pagë a shpërblim të parashikuar në gërmën "a", të nenit 8 të këtij ligji, mban tatimin mbi të ardhurat personale, në përputhje me paragrafin e parë, të nenit 9 të këtij ligji dhe e derdh tatimin e mbajtur në favor të organeve tatimore, jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës.*

Në nenin 114 të ligjit 'për procedurat tatimore' parashikohet se "Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar në këtë ligj për pagesë, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 5 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për secilin muaj apo pjesë të muajit, gjatë të cilit pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, shuma nuk mund të jetë më e vogël se 10 000 lekë dhe më e madhe se 25 për qind e detyrimit të papaguar.

2. Për qëllime të këtij neni, shuma e papaguar e detyrimit tatimor ose kërkesës së pasaktë të rimbursimit është diferenca ndërmjet detyrimit tatimor, që duhet paguar, ose shumës së saktë të rimbursimit dhe shumës së tatimit të paguar apo rimbursimit të marrë në datën e caktuar.

Rezulton se pala paditëse e ka derdhur tatimin mbi të ardhurat personale brendaafatit të caktuar me ligj por gabimisht është pasqyruar në llogarinë e sigurimeve shëndetësore.

Në nenin 75 të ligjit nr.9920, datë 19.05.200 'për procedurat tatimore në RSH' parashikohet se' **Kur shuma e detyrimit tatimor të paguar është më e madhe se shuma e tatimit të vlerësuar në njoftimin për vlerësimin tatimor, administrata tatimore e kalon shumën e paguar më tepër për llogari të detyrimeve të tjera tatimore, të papaguara nga tatimpaguesi.**

Pas kësaj, me miratimin, me shkrim, të tatimpaguesit, shuma e mbetur, nëse ka:

a) rimbursohet automatikisht, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e derdhjes së shumës së paguar më tepër;

b) kalohet për llogari të detyrimeve tatimore të ardhshme të tatimpaguesit.



Veprimet për shumën e paguara më tepër për detyrimet tatimore regjistrohen në dosjen e tatimpaguesit.

Në nenin 76 të ligjit parashikohet se "Kur detyrimi tatimor nuk paguhet në afat, tatimpaguesi është i detyruar që, për periudhën nga afati i pagesës deri në datën e pagesës së tatimit, të paguajë kamatëvonesë për këtë shumë, në masën e përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.

2. Nëse një rimbursim, i cili duhej kryer nga administrata tatimore, sipas nenit 75 të këtij ligji, nuk kryhet brenda 30 ditëve kalendarike, administrata tatimore paguan kamatëvonesë për shumën e paguar më tepër, si më poshtë:

a) kur një shumë e paguar më tepër kreditohet kundrejt një detyrimi tatimor tjetër, kamatëvonesa paguhet duke filluar nga data e pagesës më tepër deri në afatin e pagesës së tatimit, kundrejt të cilit bëhet kreditimi;

b) kur një shumë e paguar më tepër rimbursohet, kamatëvonesa paguhet për periudhën nga 30 ditë pas bërjes së pagesës më tepër deri në kryerjen e rimbursimit.

3. Masa e kamatëvonesës, sipas këtij neni, është 120 për qind e shkallës së interesit ndërbankar të Bankës së Shqipërisë, që përcaktohet çdo tremujor, në bazë të shkallës mesatare të tremujorit paraardhës.

4. Kamatëvonesa paguhet në çdo rrethanë dhe nuk mund të hiqet nga administrata tatimore, as të ankimohet, me përjashtim të rasteve kur ka gabime në llogaritje ose kur detyrimi tatimor, për të cilin zbatohet, ndryshon.

Rezulton se pala paditëse e ka paguar rregullisht dhe brenda afatit ligjor detyrimin tatimor si për tatimin mbi të ardhurat personale ashtu dhe për sigurimet shëndetësore dhe për shkak të një gabimi njerëzor nga Dega e Thesarit Fier është vendosur në vonesë dhe sistemi tatimor e ka nxjerrë debitor palën paditëse duke i akorduar dhe gjobë dhe kamatvonesat për shumën e detyrimit tatimor për të ardhura personale të paguara por që ka kaluar në numrin e llogarisë së sigurimeve shëndetësore.

Bazuar në nenin 108.5 të udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 'Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë' parashikohet se 'Në procedurën e ankimit, barra e provës për të provuar që akti administrativ është i gabuar bie mbi ankimuesin.

Rezultoi se akti administrativ njoftim vlerësimi tatimor me nr.6888 prot, datë 05.05.2014 për detyrimet, gjobë dhe kamatëvonesë të vonuar për kontribute të sigurimeve shoqërore për periudhën shkurt 2014 është një akt administrativ i nxjerrë në kundërshtim me ligjin dhe si i tillë bazuar në nenin 118 të K.Pr.Administrative është një akt relativisht i pavlefshëm dhe si i tillë duhet të anulohet.

Në asnjë rast nuk mund të ndëshkohet një tatimpagues i rregullt vetëm për shkak të një gabimi njerëzor që ka kryer një organ publik dhe jo vetë ai.

Në nenin 118 të K.Pr.Administrative parashikohet se "Aktet administrative do të quhet relativisht të pavlefshme ato akte që në kuptim të këtij Kodi janë nxjerrë në kundërshtim me ligjin por megjithatë nuk janë absolutisht të pavlefshme.

Rezulton se akti administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet



tatimore me nr.6888 prot, datë 05.05.2014 i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve për lënë në fuqi nga vendimi me nr./11387/1 prot, datë 04.08.2014 nga Drejtoria e Apelit Tatimor është nxjerrë në kundërshtim me ligjin dhe si i tillë duhet të shfuqizohet.

Për sa i përket kërimit të dytë për rregullimin e pasojave duke pasqyruar në sistem gjendjen kreditore prej 272.866 lekë të Sigurimeve Shoqërore 2013/12 duke e kaluar për sigurimet shëndetësore shkurt 2014, gjykata për shkak se pala paditëse ashtu dhe personi i tretë kanë pranar se ky rregullim është kryer, bazuar dhe në shkresën me nr. 962 prot, datë 24.03.2014, gjykata pasi mori pretendimet e palë paditëse në konkluzionet përfundimtare e cila kërkoi pushimin për këtë pjesë, bazuar në nenin 201 të K.Pr.Civile vendos pushimin për këtë kërkim.

**Sa më sipër, gjykata çmon se kërkesë padia duhet të pranohet për kërkimin e parë dhe të pushohet për kërkimin e dytë.**

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata, bazuar në nenin 40 dhe 41 të ligjit nr.49/2012 "**Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative**", nenet 306-310 të Kodit të Procedurës Civile

### **V E N D O S I**

1.Pranimin pjesërisht të kërkesë-padisë.

2.Shfuqizimin e aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.68888 prot, datë 05.05.2014 për detyrimet gjobë e kamatvonesave për pagesë të vonuar për kontribute të sigurimeve shoqërore shëndetësore për periudhën 2014/02 të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier lënë në fuqi me vendimin e Drejtorisë së Apelit Tatimor me nr.11387/1 prot, datë 04.08.2014.

3.Pushimin për pjesën tjetër të padisë.

Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative e Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së vendimit.

Per palet ne mungese, ky afat fillon nga dita e nesërme e njoftimit te vendimit.

Kundër vendimit të pushimit, mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën Administrative e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së vendimit.

Per palet ne mungese, ky afat fillon nga dita e nesërme e njoftimit te vendimit.



Ushpall në Vlorë, sot më datë 08.10.2014.

**Sekretarë**

**Milena MERSINI**

**SHPENZIMET GJYQËSORE**  
Taksa e rregjistrimit

**TOTALI**

3000 lekë

3000 lekë

**GJYQTARE**

**Gentiana XHELILI (RROKAJ)**

Vendimi mori formë të prerë

Sot më datë 05/12/2014

KANCELARE Tavile MYFTYRI

